



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 2, datë 30.01.2026**

**MBI**  
**FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2026**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35 e vijues të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E :**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 35, pika 7, e Ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen funksionet e entit kompensues për kryerjen e pagesave të dëmeve të parashikuara në nenin 41 të këtij ligji dhe kontributet e nevojshme për pagesën e këtyre dëmeve përballohen nga Fondi i Kompensimit.

Në zbatim të nenit 41, pika 4, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit.

Gjithashtu, në bazë të nenit 40, të Ligjit nr. 32/2021, shoqëritë e sigurimit krijojnë dhe mbajnë provigjonet e dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 41, të këtij ligji.

Byroja me e-mail-in e datës 30 dhjetor 2025 dhe shkresën nr. 178 prot., datë 15.01.2026, protokolluar me tonën 188 prot., datë 16.01.2026, depozitoi në Autoritet vendimin nr. 14, datë 29.12.2025 “Për miratimin e masës së kontributit për fondin e kompensimit për vitin 2026”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Masa e kontributit për fondin e kompensimit për vitin 2026, të jetë në vlerën 250,000,000 lekë.
2. Provigjonet e dëmeve të fondit të kompensimit për rastet e përcaktuara në nenin 41, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të krijohen në vlerën prej 523,628,296 lekë, të cilat do të pasqyrohen nga shoqëritë e sigurimit, në pasqyrat financiare të vitit 2025.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit:
  - 3.1. Të llogarisë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të fondit të kompensimit sipas pikës 1, të këtij vendimi;
  - 3.2. Të llogarisë dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive për krijimin e provigjonit për shpenzime sipas pikës 2, të këtij vendimi.
4. Fondi i kompensimit për vitin 2026 të vlerësohet në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026.
5. Ngarkohen departamentet përkatëse, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
Saimir TOLA

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
Adela XHEMALI